

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vuçiç përballë testit të tetorit. A po përfundon epoka e tij, apo ndryshon thjesht karrigen?
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/vucic-perballe-testit-te-tetorit-a-po-perfundon-epoka-e-tij-apo-ndry-i1184810
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 16:35:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 16:28:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a5f875a97c2be7d01cbf4231e843e750575ee522c963153bf3b344b2358bce7e
TEKSTI	d43322c3f3ceb36a72f5e579807618a59386e328de773e4155421a13f296082a
PAMJA	ad2a49b0971cc5dd72e2e8ab1985f9f443484f10af13c1f053fd225f9eba7d5e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	632d5f8249b366968ef2a91f9f3e98c2c3cedf096bb93a416cdebdac7ba868bb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/632d5f8249b366968ef2a91f9f3e98c2c3cedf096bb93a416cdebdac7ba868bb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



- [Shqipëria](#)
- [Kosova](#)
- [Rajoni & Bota](#)
- [Argëtim](#)
- [Sport](#)
- [Turizëm](#)
- [Blog](#)
- [Speciale A2](#)
- [Moti](#)
- [Emisionet](#)



Vuçiç përballë testit të tetorit. A po përfundon epoka e tij, apo ndryshon thjesht karrigen?

Nga Rosalba Bejdo
10 Shtator 2026, 18:28 | [Rajoni & Bota](#)



Vuçiç përballë testit të tetorit. A po

Për më shumë se një dekadë, një emër ka dominuar politikën serbe: Aleksandar Vuçiç. Njeriu që kaloi nga nacionalisti flaktë në partner të Perëndimit, pa hequr dorë kurrë nga lidhjet me Moskën dhe Pekinin.

Lideri që premtoi modernizim dhe zhvillim ekonomik, por që sot përballlet me protestat më të mëdha që nga rrëzimi i Slobodan Millosheviçit. Tani ai ka njoftuar se do të largohet nga posti i presidentit. Por a po largohet vërtet nga pushteti, apo thjesht po ndryshon karrigen?

Vuçiç hyri në politikë në vitet '90, në periudhën më të errët të Serbisë moderne. Jurist me profesion, ai u bë ministër i Informacionit në qeverinë e Slobodan Millosheviçit, pikërisht gjatë bombardimeve të NATO-s në vitin 1999. Ishte periudha kur mediat kritike mbylleshin, gazetaret ndëshkoheshin dhe propaganda shtetërore dominonte hapësirën publike.

Pak vite më vonë, si drejtues i Partisë Radikale Serbe të Vojislav Sheshelit, Vuçiç ishte një nga zërat më të fortë të nacionalizmit serb. Pamjet e asaj kohe e tregojnë duke kënduar këngë nacionaliste dhe duke mbrojtur idenë e "Serbisë së Madhe", ideologji që ushqeui luftërat e përgjakshme të ish-Jugosllavisë. Por politika serbe do të ndryshonte. Edhe Aleksandar Vuçiç.

Në vitin 2014 ai fiton zgjedhjet dhe bëhet kryeministër. Në atë kohë Serbia kishte nisur negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe Vuçiç paraqitej si reformatori i ri që do ta çonte vendin drejt Brukselit. Megjithatë, ai nuk hoqi dorë nga partneriteti tradicional me Rusinë.

Vetëm pak muaj pasi mori detyrën, në Beograd mbërriti Vladimir Putin. Presidenti rus u prit me nderime ushtarake dhe paradë madhështore — pamje që dëshmonin se Serbia nuk kishte ndërmend të zgjidhte vetëm një kamp.

Në të njëjtin vit ndodhi edhe një nga përplasjet më të forta diplomatike me Shqipërinë. Vizita historike e kryeministrit Edi Rama në Beograd, e para e një lideri shqiptar pas gati shtatë dekadash, u shndërrua në debat publik për Kosovën.

"Nuk prisja që kryeministri Rama të provokonte duke folur për Kosovën. Sipas Kushtetutës sonë, Kosova është pjesë e Serbisë dhe askush nuk do ta poshtërojë Serbinë në Beograd", tha Vuçiç.

Një vit më vonë, Vuçiç do të përballlej me një tjetër moment simbolik. Ai mori pjesë në ceremoninë e 20-vjetorit të masakrës së Srebrenicës, por ceremonia u kthye në kaos. Familjarët e viktimave dhe të pranishmit e pritën me fishkëllima, gurë dhe shishe. Vuçiç u detyrua të largohej me nxitim—një kujtesë se e kaluara e tij nacionaliste vazhonte ta ndiqte.

Në vitin 2017 ai zgjidhet president i Serbisë. Edhe pse posti konsiderohet kryesisht ceremonial, pushteti real mbeti në duart e tij. Ai emëron Ana Brnabiç si kryeministren e parë grua dhe hapur homoseksuale në historinë e Serbisë, por askush nuk kishte dyshim se vendimet vazhdonin të merreshin nga Vuçiç.

Ndërkohë ekonomia serbe nisi të rritej. Papunësia ra ndjeshëm, ndërsa investimet e huaja u shumëfishuan. Kompani kineze blenë miniera, uzina çeliku dhe investuan miliarda euro në infrastrukturë. Vuçiç e paraqiti këtë si provë të suksesit të modelit të tij politik, por kritikët flisnin për një realitet tjetër: kapjen e institucioneve, kontrollin mbi mediat dhe dobësimin e demokracisë.

Në fund të vitit 2018 shpërthyen protestat e para masive, ku mijëra qytetarë dolën në rrugë me sloganin "Një nga pesë milionë", pasi Vuçiç kishte deklaruar se nuk do të dorëzohej edhe sikur pesë milionë njerëz të protestonin kundër tij.

Pas pushtimit rus të Ukrainës, Vuçiç u gjend përballë dilemës më të madhe të karrierës së tij. Serbia dënoi agresionin rus në OKB, por refuzoi të vendoste sanksione ndaj Moskës. Fluturimet drejt Rusisë vazhduan, ndërsa në rrugët e Beogradit marshonin qytetarë të flamur rusë. Vuçiç vazhdoi politikën e balancimit: takonte Macronin e Scholz-in, por njëkohësisht priste Xi Jinpingun dhe ruante marrëdhënie të ngushta me Kremlinin.

"Serbia është në rrugën europiane, por dëshiron të ruajë miqësinë tradicionale me Kinën dhe Federatën Ruse. Për shumëkënd ky pozicion është i pamundur, por ky është interesi ynë", u shpreh Vuçiç.

Në raport me Kosovën, Vuçiç pranoi dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja dhe zhvilloi disa takime me kryeministrin Albin Kurti. Megjithatë, procesi stagnoi sepse Serbia refuzoi nënshkrimin dhe zbatimin e pikave kyçe të Marrëveshjes së Ohrit që lidheshin me njohjen de facto.

Përpjekjet për normalizim morën goditjen më të rëndë pas sulmit mbrojtës në Banjskë të Zveçanit, i marrë përsipër nga Milan Radoiçiç, bashkëpunëtor i afërt i Vuçiçit. Pavarësisht fletëarrestit të Interpol-it dhe kërkesave të prera të BE-së, Vuçiç i ofroi Radoiçiçit mbrojtje nga shteti serb, duke refuzuar ta ndjekë penalisht.

Retorika e tij ndaj Kosovës u ashpërsua edhe më tej përmes promovimit të konceptit të "Botës Serbe"—një rikthim i ideve të viteve '90 me ambalazh të ri. Sa herë që përballlej me kriza të brendshme, Vuçiç përdorte Kosovën si mjet shpërqendrimi: akuzonte Prishtinën për "spastrim etnik" dhe ngrinte vazhdimisht gatishmërinë luftarake të ushtrisë në kufi.

Paralelisht me këtë retorikë kërcënuese, ai nisi një armatosje masive të Serbisë me sisteme kineze, ruse dhe avionë ushtarakë francezë, duke ngjallur shqetësime serioze te fqinjët dhe Perëndimi për destabilizimin e rajonit.

Në fund të vitit 2023, Vuçiç shpalli një tjetër fitore zgjedhore, por menjëherë shpërthyen protesta ku opozita e akuzoi për manipulim. Goditja më e madhe politike erdhi në nëntor të vitit 2024, kur shembja e strehës prej betoni në stacionin hekurudhor të Novi Sadit vrau 16 persona.

Ngjarja u bë simbol i korrupsionit shtetëror dhe mungesës së kontrollit. Qindra mijëra serbë dolën në demonstratat më të mëdha që nga rrëzimi i Millosheviçit, ndërsa organizatat ndërkombëtare akuzuan autoritetet për dhunë ndaj protestuesve dhe shtypje të medias.

"Ne arritëm të ndryshojmë fytyrën e Serbisë, pavarësisht presioneve të vazhdueshme nga jashtë dhe nga brenda", tha Vuçiç.

Sot, pas më shumë se 12 vitesh në krye të shtetit, Aleksandar Vuçiç thotë se do të largohet nga presidenca. Por pak besojnë se ai po braktis pushtetin. Analistët presin që ai të rikthehet në krye të Partisë Progresiste Serbe dhe të synojë postin e kryeministrit, duke përsëritur formulën e tij të njohur të kontrollit absolut.

Prandaj pyetja nuk është nëse po përfundon epoka e Vuçiçit, por nëse Serbia është gati të hyjë në një epokë pa të.

Sepse për më shumë se një dekadë, Aleksandar Vuçiç nuk ka qenë thjesht presidenti i Serbisë. Ai ka qenë vetë sistemi politik serb. **(A2 Televizion)**

A2 CNN Livestream

MUND TE LEXONI GJITHASHTU

[“Serbët nuk kanë pse të pendohen!”, Zakharova: Brukseli do të imponohet, njësoj si me Kosovën](#)

18:15

[Ndahet nga jeta këngëtari i njohur grek Giorgos Mazonakis](#)

17:28

[Ballkani “fushëbeteja” e re e Rusisë? Joseph: Serbia, platformë për luftën hibride ruse në rajon!](#)

19:27

[Mitsotakis: Greqia ka të drejtë të zgjerojë ujërat territoriale me 12 milje](#)

15:15

[Mickoski viziton Pustecin, në ceremoninë e aktivitetit këndohet vetëm himni maqedonas](#)

19:05

[Ishte në muaj mjalti, çifti i ri britanik humbet jetën në aksidentin me helikopter në Greqi](#)

13:42

TE FUNDIT

[Ukraina depërton 3 mijë km në Rusi, Zelenski i shpëton sulmit me dron, Trump: Putin do marrëveshje](#)

18:25

[Reagon OVL e UÇK: Nuk fshihet dot dështimi i një prokurorie të njëanshme!](#)

18:12

["Prokuroria nuk është e qartë", Avokatja: ZVP nuk ka provë për ndërhyrjen e Thaçit](#)

18:08

[Programi i ri i strehimit, Rama: 7 mijë përfitues, prioritet çiftet e reja dhe emigrantët](#)

17:41

MË TË VIZITUARAT

[Sesioni i ri parlamentar, e ngarkuara me punë e SHBA takim vetëm me Gazment...](#)

17:38

[25 vjet pas 11 shtatorit, sondazhi zbulon gjurmën e thellë që la tragjedia te...](#)

17:36

[Reforma e re territoriale, Rrajca braktis dëgjesat me deputeten Bora Muzhaqi](#)

17:13

Live Updates

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

07:28

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

09:08

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

10:52

Latest Videos

 Deklarata e fortë e avokatit: Provat ndaj UÇK-së u manipuluan

Deklarata e fortë e avokatit: Provat ndaj UÇK-së u manipuluan

 "Mbrotjja e Thaçit ka bërë punë të mirë", Bajraktari: Dëshmitarët cilësorë

"Mbrotjja e Thaçit ka bërë punë të mirë", Bajraktari: Dëshmitarët cilësorë

 Akuzat ndaj Thaçit, avokati: Haga po ngre alibi, UÇK s'ka kryer krime

Akuzat ndaj Thaçit, avokati: Haga po ngre alibi, UÇK s'ka kryer krime

 "Haga ka dështuar", avokati nga Kosova: Provat ndaj Thaçit, të kontestueshme

"Haga ka dështuar", avokati nga Kosova: Provat ndaj Thaçit, të kontestueshme

- [Shqipëria](#)
 - [Aktualitet](#)
 - [Kronikë](#)
 - [Politikë](#)
 - [Ekonomi](#)
 - [Sociale](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Moti](#)
- [Kosova](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Sociale](#)
 - [Ekonomi](#)
 - [Politikë](#)
 - [Kronikë](#)
 - [Aktualitet](#)
- [Rajoni & Bota](#)
 - [Ballkani](#)
 - [Bota](#)
- [Argëtim](#)
 - [Showbiz](#)
 - [Lifestyle](#)
 - [Kapur në kamera](#)
 - [Teknologji](#)
- [Sport](#)
 - [Live Euro 2024](#)
 - [Futboll](#)
 - [Sporte të tjera](#)
- [Speciale A2](#)
 - [5 gjëra në 5 minuta](#)
 - [A2 CNN në Izrael](#)
 - [31 Minuta](#)
 - [A2 CNN në Ukrainë](#)
 - [Lumi i kokainës](#)
 - [Ditari ndërkombëtar](#)
 - [Zbulo](#)
 - [Imagjinatë](#)
 - [Dëshmi](#)
- [Shqipëria](#)
- [Rajoni & Bota](#)
- [Argëtim & Teknologji](#)
- [Sport](#)
- [Fotolajme](#)
- [Moti](#)
- [Live Updates](#)
- [Speciale A2](#)
- [Emisionet](#)



 A2 CNN LOGO
[Live TV](#)



Breth nesh [Kushtet e Privatësisë](#) [Karriera](#) [Kontakt](#)

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.